

## Devoniani

417-354 milionë vjet më parë

Berthama e  
brendshme e  
ngurte

Strajet e Rhyenit në Skoci janë depozitime devoniane që përmbajnë fosile të Zosterophyllophyteve dhe Trimerophytes, dy prej linjave më të mëdha të bimëve vaskulare. Kjo tregon që prioritare në fillimin e devonianit, shpërthimi i parë më i madh i bimëve kishte filluar. Bimët më të vjetra vaskulare që njihen në Hemisferën Veriore i përkasin Devonianit. Vegjetacioni i devonianit të hershëm konsiston së pari në bimë të vogla, gjatësia e të cilave nuk i kalonte një metërshin. Nga fund i Devonianit, fieret, bishtkalet dhe bimët me fare ishin shfaqur, duke krijuar kështu pemët dhe pyjet e parë. Archaeopteris është një nga këto pemë të para. Gjithashtu gjatë Devonianit, dy grupe të mëdha kafshësh, kolonizuan tokën. Të parat terapodet, ose vertebratët që jetonin në tokë, u shfaqën gjatë Devonianit, dhe u dukën arthropodët e parë tokësorë, duke përfshirë isektet pa krahë dhe arachnidet. Në oqean, brachipodët lulëzuan, siç ishte *Paraspirifer bownockeri*. Krinoidet dhe të tjerë echinoderma-të, tabulate dhe corale me rrudha, si dhe ammonite ishin gjithashtu të zakonshëm. U shfaqën edhe disa lloje peshqish. Gjatë devonianit, pati tre masa kontinentale kryesore: Amerika e Veriut dhe Europa qëndronin bashkë mbi ekuator, pjesa më e madhe e të cilave gjendej nën ujë. Në veri shtresëzohej një cope e Siberisë moderne. Një bashkim i kontinenteve të Amerokës së Jugut, Afrikës, Antraktidës, Indisë dhe Australisë dominonte në hemisferën jugore.